



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA PERMET
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 222/12 Prot.

Përmet, më 18/07/2022

NJOFTIM

**Kalendari i konsultimeve me publikun i
Buxhetit te Bashkise Permet per vitin 2023**

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit Nr. 146/2014 Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik në nenin 9 pika 1.3, nenin 34; të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar; nenin 34 të ligjit nr.68/2017 ”Për financat e veteqeverisjes vendore”; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV” të ndryshuar; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.08 datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendorë 2023-2025”.

Bashkia Përmet fton banorët, grupet e interesit dhe organizatat e shoqërisë civile në dëgjuesat që do të organizohen për:

1. *Projekt-Buxhetin Afatmesëm të Bashkisë Përmet 2023-2025*
2. *Projekt-Buxhetin 2023:*
3. *Projekt-Paketën Fiskale 2023*

Dokumentacioni i mësipërm pasqyrohet në faqen zyrtare të Bashkisë Përmet dhe/ose në Platformën www.konsultimivendor.al

Hartimi dhe miratimi i Buxhetit të Bashkisë Përmet është një proces i rëndësishëm jo vetëm për bashkinë por edhe për banorët të cilët janë kontributorë direkt me taksat e tyre në të ardhurat e Pushtetit Vendor. Caktimi i prioriteve mbi planet e investimit përmes procesit të konsultimeve me publikun është një detyrim ligjor të cilin Bashkia Përmet synon të përmbushë në kohë dhe me cilësi.

Ngarkohet Drejtoria e Financave/ Komisioni i Ekonomise dhe Financave do te informoje komunitetin mbi te dhenat e raportit te monitorimit te zbatimit te buxhetit te bashkise per vitin 2022, tavanet buxhetore pergatitore per secilin program/sherbim te ofruar nga bashkia.

Ngarkohet Koordinatorin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik për të realizuar njoftimin mbi kalendarin e degjesave me publikun përmes publikimit online në faqen zyrtare të Bashkisë dhe/ose në Platformën www.konsultimivendor.al si dhe përmes ndërveprimit të shtuar me kryepleqtë e fshatrave dhe administratorët për njoftimin me mjete të efektshme njoftimin mbi datat dhe vendin e takimeve me komunitetin.

Kalendari i Dëgjesave:

Nr	Aktiviteti	Data	Vendi	Ora	Mënyra	Forma
1	Konsultim publik me banore, OSHC Përmet, gazetarë, Shoqerine civile, Biznesin e vogël	16.11.2022	Qendra Multifunktionale	11:00	Takim publik	Bisede
2	Konsultim publik me banore të Nj.A Petran	25.10.2022	Njesia Administrative Petran	10:00	Takim publik	Bisede
3	Konsultim publik me banoret e Nj.A Piskove dhe Nj.A Frasher	03.11.2022	Njesia Administrative Piskove	10:00	Takim publik	Bisede
4	Konsultim publik me banoret e Nj. A Carshove	09.11.2022	Njesia Administrative Carshove	11:00	Takim publik	Bisede
5	Konsultim publik me të gjithë qytetaret	18.11.2022	Lagjia Mejden	17:00	Takim Publik	Dëgjese/bisede
6	Konsultim publik me të gjithë qytetaret	19.11.2022	Lagjia e Re	17:00	Takim Publik	Dëgjese/bisede
7	Konsultim publik me të rinjtë e qytetit	21.11.2022	Salla e Mbledhjeve të Këshillit	10:00	Takim publik	Bisede

Jeni të ftuar të shprehni opinionin, sugjerimet dhe rekomandimet tuaja përmes adresave të e-maili: info@bashkiapermet.gov.al dhe/ose kristjana.ibrahimi@gmail.com
 Jeni gjithashtu të ftuar të merrni pjesë direkt në dëgjesat publike që do mbahen sipas kalendarit që përmban ky vendim:

Shenim: Ky njoftim afishohet pranë zyrave të Njesive Administrative, publikohet online në seksionin njoftime të faqes së Bashkisë Përmet, në Platformën www.konsultimivendor.al dhe promovohet rrjetet sociale, të paktën 10 dite para mbajtjes së takimit të parë, dhe në çdo rast pas publikimit në web të materialeve që janë hedhur në konsultim publik.

SEKRETARI KËSHILLIT

Aleks Tane



KRYETARI I BASHKISË

Alma HOXHA


